



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Tiani Construction" Sh.P.K. të datës 15.09.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së- Ritender" me nr. të prokurimit 616-24-8898-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e palejuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Tiani Construction" Sh.P.K. të datës 15.09.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së- Ritender" me nr. të prokurimit 616-24-8898-2-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Tiani Construction" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 15.09.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së- Ritender" me nr. të prokurimit 616-24-8898-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është parashtruar nga personi i paautorizuar respektivisht personi që nuk është palë e interesuar për këtë aktivitet të prokurimit. Pas publikimit të njoftimit për pezullimin e aktivitetit të prokurimit për shkak të paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim, me datë 16.09.2024 autoriteti kontraktues ka pranuar një email nga pronari i kompanisë

“Tiani Construction” Sh.P.K. me përmbajtjen si vijon: “*Pershendetje i nderum une jom pronar i TIANI CONSTRUCTION SHPK un merrem me ndertim vlla ma kan keqperdor imazhin e firmes kan bo aplikim te pa autorizum*”. Mbi këtë bazë AK ka gjetur se kërkesa për rishqyrtim është dorëzuar në kundërshtim me nenin 59 të RRPP dhe duhet të refuzohet si e palejuar.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 16.09.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.